



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 286/9 prot.

Tiranë, më 21.07.2020

VENDIM
Nr.79, datë 21.07.2020

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 32, DATË 07.5.2020

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 32, datë 07.05.2020, të Komisionerit, “Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë të procedurës së lëvizjes paralele, për grupin e pozicioneve me kod #2555, me konkurrent nëpunësin *****”,

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet ankesës të regjistruar me nr. 220 prot., datë 21.02.2020, ***** , ka ngritur pranë Komisionerit disa pretendime për parregullsi dhe shkelje të lejuara në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi nuk është plotësuar vlerësimi i fundit i punës në shërbimin civil, çka e ka penguar atë për të marrë pjesë në procedurën e lëvizjes paralele, për grupin e pozicioneve me kod #2555, për pozicionin e punës “Përgjegjës” në Sektorin e Prokurimeve, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri, ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti duke kërkuar nga institucioni i Ministrisë së Brendshme, informacion në lidhje me faktin nëse janë plotësuar ose jo vlerësimet e punës për nëpunësit civilë, e në veçanti për ankuesin ***** , për periudhën Janar-Qershor 2018.

Në përfundim të hetimit administrativ procesi është përmbyllur me Vendimin Nr.32, datë 07.05.2020, “Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë të procedurës së lëvizjes paralele, për grupin e pozicioneve me kod #2555, me konkurrent nëpunësin ***** ”.

Me kalimin e afatit të lënë në Vendimin e mësipërm, me shkresën nr. 2363/4 prot., datë 22.05.2020, “*Kthim përgjigje*”, Ministria e Brendshme ka informuar Komisionerin në lidhje me veprimet administrative të ndërmarra në zbatim të detyrave të lëna në dispozitivin e vendimit paralajmërues, duke bashkëngjitur dokumentacionin që provon zbatimin e tij.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin Nr. 32, datë 07.05.2020, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Komisioneri në *pikën 1, 2 dhe 3*, ka kërkuar nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë Ministrisë së Brendshme që, në bashkëpunim me titullarin e institucionit të varësisë, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, të udhëheqë procesin për të përfunduar vlerësimin e pjesshëm individual të punës për ankuesin ***** , për periudhën Janar-Qershor 2018.

Njëkohësisht, me qëllim përmbushjen e detyrimeve në lidhje me institutin e vlerësimit të punës, për nëpunësit civilë të institucionit të përfshirë në procesin e ristrukturimit, njësia e burimeve njerëzore në Ministrinë e Brendshme të njoftojë të gjithë nëpunësit që përfitojnë nga ky veprim, duke i dërguar atyre aktin e vlerësimit, i cili duhet të përfshihet në Regjistrin Qendror të Personelit.

Në lidhje me detyrat e mësipërme, nga dokumentacioni i administruar në dosjen e verifikimit, rezulton se njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë Ministrisë së Brendshme, në bashkëpunim me titullarin e institucionit të varësisë, Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, kanë përfunduar vlerësimin e punës për periudhën 1 janar-8 qershor 2018, për ankuesin në fjalë.

Me shkresën nr. 2365/4 prot., datë 22.05.2020, Sekretari i Përgjithshëm, ka informuar se, për periudhën janar - qershor 2018, në Drejtorinë e Përgjithshme të Prokurimeve të Përqendruara pranë Ministrisë së Brendshme, nuk ka pasur asnjë nëpunës që t’i jetë mohuar mundësia për të përfutuar nga e drejta që njeh pika 8, e nenit 50, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Veprimet administrative të kryera më sipër në zbatim të vendimit paralajmërues të Komisionerit i janë komunikuar edhe Departamentit të Administratës Publike.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 32, datë 07.05.2020, të Komisionerit, *“Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë të procedurës së lëvizjes paralele, për grupin e pozicioneve me kod #2555, me konkurrent nëpunësin *****”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Ministria e Brendshme, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 32, datë 07.05.2020.
3. Për këtë vendim të njoftohet Ministria e Brendshme, titullari i Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara dhe nëpunësi *****.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

Konceptoi: S. Ndoka

Pranoi: E. Hebibasi

Miratoi: A. Basha